



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Milaim Sylejmani	04.08.2026	04.08.2026	2026/0560

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.08.2026, OE “Intercert L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0560, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapesires nga materiet qe permbajne azbest ne TCB” me nr. të prokurimit: "KEK-26-5875-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 52,000 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Nr. i Prokurimit: KEK-26-5875-2-2-1

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materialet që përmbajnë azbest në TCB.

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e tij, kërkojmë sqarim dhe njëkohësisht rishqyrtim të kriterit të kualifikimit teknik të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, sipas të cilit operatori ekonomik duhet të posedojë "licencë ose pëlqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit."

Ky kriter nuk është i zbatueshëm në praktikë, pasi në Republikën e Kosovës ende nuk ekziston një rregullativë ligjore që rregullon licencimin ose dhënien e pëlqimit për operatorët ekonomikë për largimin apo trajtimin e materialeve që përmbajnë azbest. Për rrjedhojë, nuk ekziston procedurë administrative dhe as bazë ligjore për lëshimin e një licence apo pëlqimi të tillë nga autoriteti kompetent.

Vendosja e një kriteri që nuk mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe që objektivisht nuk mund të përmbushet nga operatorët ekonomikë, kufizon konkurrencën, cenon parimin e proporcionalitetit dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

Aktualisht, mekanizmi i vetëm zyrtar dhe i rregulluar në Republikën e Kosovës për garantimin e kompetencës profesionale në këtë fushë janë Institucionet e Akredituara në Republikën e Kosovës, dhe jasht saj, për ofrimin e programeve të trajnimit dhe certifikimit profesional të personelit që kryen punë me azbest dhe materiale me përmbajtje azbesti. Për rrjedhojë, kompetenca profesionale në këtë fushë dëshmohej përmes personelit të certifikuar nga një institucion i akredituar, që tashmë ekziston në vendin tonë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë që kriteri:

"Operatori Ekonomik duhet të posedojë licencë ose pëlqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit."

të hiqet nga Dosja e Tenderit dhe të zëvendësohet me kriterin si vijon:

"Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon personel të certifikuar për trajtimin e azbestit dhe materialeve me përmbajtje azbesti, të pajisur me certifikata të lëshuara nga një institucion i akredituar në Republikën e Kosovës."

Ky kriter është në përputhje me standartet profesionale dhe kuadrin në Republikën e Kosovës, i cili garanton kompetencën profesionale të personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës, siguron mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe mundëson zhvillimin e një procedure të prokurimit në përputhje me parimet e konkurrencës së drejtë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, rikujtojmë se edhe në raste të mëparshme të aktiviteteve të ngjashme të prokurimit, organet kompetente të shqyrtimit kanë vlerësuar se kërkesat për dokumente të cilat nuk parashihen nga legjislacioni në fuqi nuk mund të përdoren si kriter kualifikimi, pasi ato krijojnë pengesa të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.


Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishikojë këtë kriter dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në Dosjen e Tenderit, në mënyrë që procedura të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet themelore të prokurimit publik.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe presim shqyrtimin e kërkesës sonë.

Me respekt,

Per Intercert Ilc

Kreshnik Hoxha



KRITERET PËR VLERËSIM

--

		Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65; 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit; 3. Certifikata nga Gjykata me të cilat vërtetohet se a. Drejtori, ndonjë drejtues ose menaxher i Operatorit Ekonomik, gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësore.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit; Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pikat 2,3 dhe 4 do të kërkohe nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.
Kërkesat e	7.1 & 7.2	Profesionalna podobnost 1.Regjistrimi si operator	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Një dokument i lëshuar nga
përshtatshmërisë profesionale		ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; në vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal	autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e certifikatës TVSH-se; 3. Kopja e certifikatës numrit fiskal
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Ekonomski i finansijski kapacitet	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Tehničke i profesionalne mogućnosti 1. Licence apo pëlqim.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Licencë apo pëlqim nga Ministria e Planifikimit Hapsinor për trajtimin e

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N.A.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE Ankues është pale me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Intercert L.L.C.**

Pretendimi i OE ankues: *OE ankues pretendon se kërkesa në FTD që ofertuesi të posedon Licencë nga MMPHI është e kundërligjshme dhe kërkon të zëvendosohet si më poshtë:*

Kriteri: "OE duhet të posedoj Licencë ose Pelqim nga Ministria për largimin /trajtimin e azbestit" dhe ky kriter të zëvendosohet me:

"Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon personel të certifikuar për trajtimin e azbestit dhe materialeve me përmbajtje azbesti, të paisur me certifikata të lëshuara nga një institucion i akredituar në Republikën e Kosovës"

Përgjigje e AK në Pretendimet e OE:

ANALIZA DHE SQARIMI I AK	
Sqarimi	- Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB" KEKO-26-321-221 AK ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të ekonomik ankesues OE Intercert LLC dhe refuzon me arsyen se: - Sa i përket pretendimit ankimor për përshkrim të çmimit është i pa bazuar, sepse në si AK, aktivitetin e prokurimit "Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB", kemi kërkuar "Licencë ose përqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit". - Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon kërkesën tuaj, pasi vlerëson se ky kriter është i arsyeshëm proporcional me natyrën e kontratës dhe i vendosur në përputhje me standardet dhe kërkesat Bashkimit Evropian që rregullojnë trajtimin, largimin dhe menaxhimin e materialeve që përmbajnë azbest.
REKOMANDIMI I INICUESIT TË KËRKESËS	
AK në bazë të sqarimit të lartëcekur rekomandon Zyrтарin Përgjegjës të Prokurimit që kërkesa për rishqyrtim Ekonomik : Intercert LLC për aktivitetin e prokurimit: " Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB " ,me nr. prokurimit: KEKO-26-321-221 të refuzohet si e pa bazuar.	
KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT	
Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik: Intercert LLC i cili është pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimin e inicuesit të aktivitetin e prokurimit: "Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB" KEKO-26-321-221 e refuzon si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE Intercert LLC.	
Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së konform dispozitave ligjore nga data e pranimit të vendimit. Vendimi t'i dorëzohet : 1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik 1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit të Prokurimit 1x1 ekzemplar – Arkivës së KEK-ut u.d. Drejtor i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit <u>Avdi Muzliukaj</u> 23.07.2026	

Përgjigje nga Eksperti Shqyrtues për pretendimin e ngritur nga OE: Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB" nr KEK-26-5875-2-2-1 , Autoriteti Kontraktues KEK ka vendosur në dosjen e tenderit, në seksioni II në FTD pika 9.1 dhe 9.2 kritere që janë konform neneve 1, 7, 51 të Ligjit 04/L-042 të Ligjit mbi Prokurim Publik në Kosovë. Autoriteti kompetent për

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"Intercert L.L.C."**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Largimi, asgjesimi dhe pastrimi i hapesires nga materiet qe permbajne azbest ne TCB"** me numër të prokurimit: **"KEK-26-5875-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

dhënie të lejeve apo licencave kompanive që trajtojnë materiale të rrezikshme konform Ligji 08/L-071 dhe 04/L-060 neni 38 është MMPHI- Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujrave, konkretisht Divizioni për Mbeturina dhe Kemikate. Pretendimi i OE "Intercert L.L.C" është i pa qëndrueshëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe konstatimet për pretendimin e ngritur, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues refuzimin e ankesës së Operatorit Ekonomik "Intercert L.L.C. .

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Intercert L.L.C.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB**” me numër të prokurimit: “**KEK-26-5875-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Intercert L.L.C.**

Milaim Sylejmani



Milaim Sylejmani